

# OUCH!

## NË KËTË EDICION..

- Vështrim i përgjithshëm
- Përzgjedhja e një ofruesi të shërbimit Cloud
- Sigurimi i të dhënave tuaja

## Përdorimi i sigurt i Cloud

### Vështrim i përgjithshëm

“Cloud” është një teknologji e fuqishme e cila po përdoret me ritme të shpejta si nga individët dhe nga organizatat. “Cloud” mund të kuptohet ndryshe nga njerëz të ndryshëm, por kuptimi i përgjithshëm është përdorimi i një ofruesi shërbimi të internetit për të ruajtur dhe menaxhuar të dhëna. Një përparësi e Cloud është se jo vetëm që mund të keni akses dhe të sinkronizoni lehtë të dhënat tuaja nga pajisje të ndryshme kudo nëpër botë, por edhe mund të

ndani informacion me kë të dëshironi. Arsyeja pse i quajmë këto shërbime “Cloud” [reja] është sepse shpesh ju nuk e dini ku janë të ruajtura fizikisht të dhënat tuaja. Shembuj të përdorimit të Cloud janë krijimi i dokumenteve në Google Docs, dërgimi/ndarja e dosjeve përmes Dropbox, krijimi i serverit tuaj personal në Amazon Cloud, apo ruajtja e muzikës apo fotove tuaja në iCloud të Apple. Këto shërbime online kanë potencialin t’ju bëjnë shumë më tepër produktiv, megjithatë, ato sjellin edhe rreziqe të veçanta. Në këtë buletin do ju tregojmë si të përdorni Cloud në mënyrë të sigurt.

### Botuesi i ftuar

James dhe Kelli Tarala (@isaudit / @kellitarala) janë konsulentët kryesorë të Enclave Security dhe autorë të një sërë trajnimesh SANS, përfshirë edhe SANS Audit 566: Zbatimi dhe Auditimi dhe Njëzet Kontrollë Kyçe të Sigurisë dhe MGT 415: Një prezantim praktik i Vlerësimit të Riskut.

### Përzgjedhja e një ofruesi të shërbimit Cloud

Cloud nuk është as i mirë as i keq, por është një instrument që ju mundëson të mbaroni punë si në shtëpi edhe në vendin e punës. Megjithatë, përdorimi i këtyre shërbimeve do të thotë se po i kaloni të dhëna personale disa personave të huaj dhe prisni që ata t’i mbajnë të sigurt dhe të disponueshme për ju. Kështu që duhet të siguroheni që po bëni zgjedhjen e duhur. Për sa i përket kompjuterit të punës apo informacionit në lidhje me punën, pyesni eprorin tuaj nëse mund të përdorni shërbimet Cloud. Nëse ju lejohet, mos harroni të konfirmoni se cilat shërbime Cloud mund të përdorni dhe cilat janë politikat e përdorimit të tyre. Nëse po mendoni të zgjidhni shërbimin Cloud për përdorim vetjak, merrni në konsideratë sa më poshtë:

1. **Mbështetje.** Sa e lehtë është të marrësh ndihmë apo përgjigje për një pyetje? A ka një numër telefoni apo adresë emaili që mund ta përdorni? A ka opsione të tjera që ofrojnë mbështetje për klientin si forume publike apo Frequently Asked Questions [Pyetjet më të shpeshta] në website-in e tyre?
2. **Thjeshtësia:** Sa i lehtë është përdorimi i këtij shërbimi? Sa më kompleks shërbimi, aq më shumë gabime mund të bëni dhe të ekspozoni apo humbisni informacionin tuaj aksidentalisht. Përdorni një ofrues të shërbimit Cloud që ju duket i

## Përdorimi i sigurt i Cloud


lehtë për t'u kuptuar, konfiguruar dhe përdorur.

3. **Siguria.** Si kalojnë të dhënat nga kompjuteri juaj në Cloud, a është lidhja e siguruar me kod? Si ruhen të dhënat tuaja në Cloud, a janë të koduara dhe nëse po kush mund ti dekriptojë?
4. **Kushtet e shërbimit:** Merrni pak kohë për të lexuar kushtet e shërbimit (shpesh herë lexohen shumë lehtë). Vërtetoni se kush mund t'i shohë të dhënat tuaja dhe se cilat janë të drejtat tuaja ligjore.

### Sigurimi i të dhënave tuaja

Pasi të keni përzgjedhur një shërbim Cloud, hapi tjetër është të siguroheni që po i përdorni siç duhet. Mënyra si shihni dhe i ndani të dhënat tuaja mund të ndikojë shumë më ndjeshëm se çdo gjë tjetër sigurinë e dokumenteve tuaja. Disa nga hapat kryesorë që mund të ndiqni janë:

1. **Verifikimi:** Përdorni një fjalëkalim të fuqishëm e të veçantë për të hyrë në llogarinë tuaj Cloud. Nëse ofruesi i Cloud ju jep mundësinë e verifikimit me dy hapa, ju këshillojmë ta përdorni.
2. **Ndarja e dokumenteve/dosjeve:** Cloud e bën ndarjen e dokumenteve shumë të thjeshtë, ndonjëherë më thjeshtë seç duhet. Në rastin më të keq, mund t'i bëni dokumentet apo edhe të gjithë dosjet tuaja publike për gjithë internetin. Mënyra më e mirë për të mbrojtur veten është duke mos lejuar përdorimin e dokumenteve tuaja për asnjë. Më pas, lejoni vetëm persona të caktuar (ose grup personash) të shohin disa dokumente apo dosje specifike sipas nevojës. Kur dikush nuk duhet të ketë më qasje në dokumentet tuaja fshijini ato. Ofruesi i Cloud duhet t'ju tregojë një mënyrë të thjeshtë për të parë se kush mund të ketë qasje në dokumentet dhe dosjet tuaja.
3. **Ndarja e dokumenteve/dosjeve përmes një Link-u:** Një nga karakteristikat e përbashkëta të disa prej shërbimeve Cloud është mundësia për të krijuar një lidhje interneti (Link) që të drejton te dokumentet apo dosjet tuaja. Ky instrument ju mundëson që të lejoni këdo të shohë dokumentet tuaja thjesht duke i dërguar një Link. Megjithatë, kjo qasje është shumë pak e sigurt sepse kushdo që e di link-un mund të shohë dokumentet apo dosjet tuaja personale. Nëse ia dërgoni link-un vetëm një personi, ai mund ta ndajë me të tjerë ose mund të shihet në mekanizmat e kërkimit. Nëse ndani të dhënat me të tjerë përmes një link-u, siguroni që ta çaktivizoni pasi të mos nevojitet më ose, kur është e mundur, mbrojeni me një fjalëkalim.
4. **Settings/kushtet:** Kuptoni kushtet e sigurisë të ofruara nga ofruesi i shërbimit Cloud. Për shembull, nëse ndani një dosje me dikë tjetër, a mundet ai ta ndajë me të tjerë pa dijeninë tuaj?



*Cloud mund t'i bëjë informacionet tuaja më të disponueshme dhe t'ju bëjë juve më produktiv, por kini kujdes me mënyrën si i ruani apo ndani informacionet me të tjerët.*

## Përdorimi i sigurt i Cloud

5. **Antivirusi:** Instaloni versionin më të fundit antivirus në kompjuterin tuaj dhe në çdo kompjuter tjetër që përdorni për të ndarë të dhëna me të tjerë. Nëse një dokument infektohet, edhe kompjuterët e tjerë të përdorur për të parë atë dokument mund të infektohen.
6. **Backup:** Edhe nëse ofruesi i Cloud ofron ruajtjen e të dhënave, do të ishte më mirë t'i ruanit vetë rregullisht edhe diku tjetër. Në këtë mënyrë jo vetëm që mbronni të dhënat tuaja nëse ofruesi i shërbimit Cloud ndërpret apo mbyllet si shërbim, ose nuk është më i arritshëm për çfarëdolloj arsyeje, mund të jetë shumë më e lehtë të rikuperoni sasi të mëdha të dhënash nga pajisja ku i keni ruajtur lokalisht sesa nga Cloud. Konfirmoni edhe shpeshësinë e ruajtjes së të dhënave nga ofruesi i shërbimit Cloud, nëse ju lejojnë të rigjeni versionet e mëparshme të dokumenteve tuaja, dhe sa kohë i mbajnë dokumentet të ruajtura?

## Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

## Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyesë profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

## Burimet

- Fjalëkalim i fuqishëm: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#may2013>
- Menaxherët e fjalëkalimit: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#october2013>
- Ruajtjet e dokumenteve: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#september2013>
- Kushtet e sigurisë: <http://www.securingthehuman.org/resources/security-terms>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në [ouch@securingthehuman.org](mailto:ouch@securingthehuman.org).

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis  
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



[securingthehuman.org/blog](http://securingthehuman.org/blog)



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gpl](https://www.securingthehuman.org/gpl)